

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 97, datë 28.05.2026

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 17, 20, 21 dhe 25, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr.137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbiqëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimit të z. Besim Ndrejoni si anëtar i Këshillit Mbiqëqyrës të shoqërisë së Sigurimit “Albsig” sh.a., për një afat 3 vjeçar.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI